



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:016155

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05438383

P.nr. 152/22

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Sabit Sadikaj, me bashkëpunëtorin profesional Asdren Selmani, duke vendosur sipas marrëveshjes së ndërmjetësimit me numër. Nd.68/24 të datës: 16.02.2024, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.II.nr.6086/2021 e datës: 25.01.2022, kundër të akuzuarit M.K për shkak të veprës penale “Vjedhja e Shërbimeve” nga neni 314, paragrafi.6,lidhur me par.1 te KPRK-së, jashtë seancës konform nenit 229 te KPPRK-së, dhe nenit 2 lidhur me nenin 31 të Ligjit nr. 03/L-057 për Ndërmjetësim (tutje: Ligji për Ndërmjetësim), më datë: 20.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET marrëveshja numër: Nd.68/24 të datës: 16.02.2024, e lidhur në Zyrën për Ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në mes të akuzuarit M.K me nr. personal: “letërnjoftim”, adresa: Rruga “emri i rrugës”, apo- “emri i rrugës”, Nr. ...., Komuna Prishtinë me dhe Palës së dëmtuar: KEDS-Erleta Berbatovci, Prishtine, me adrese Vendbanimi: Bulevardi “Bill Klinton” Nr.5 Prishtinë
- II. HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.II.nr. 6086/21 e datës: 25.01.2022
- III. PUSHOHET procedura penale kundër të akuzuarit: M.K me numër personal: “letërnjoftim” me Adrese Vendbanim Rr. “emri i rrugës”, apo “emri i rrugës”, nr. ...., Komuna e Prishtinës, për shkak se i akuzuari dhe e dëmtuarit KEDS- të cilën e përfaqëson Erleta Bërbatovci, me seli në Prishtine, pasi që kanë arritur marrëveshjen në procedurën e ndërmjetësimit.
- IV. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë me aktakuzën PP.II.nr. 6086/2021 e datës: 25.01.2022, ka ngritur Aktakuzë kundë të pandehurit M.K për shkak të veprës penale “Vjedhja e Sherbimee” nga neni 314, paragrafi.6,lidhur me paragrafin 1. KPRK-së.

Ashtu sikurse në dispozitën ligjore nga neni 229 paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës parashihet se: *“Para ngritjes së aktakuzës, prokurori i shtetit mund ta dërgojë kallëzimin penal për një vepër penale të dënueshme me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet apo me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet për ndërmjetësim. Pas ngritjes së aktakuzës, me miratim të prokurorit, i dëmtuari dhe i pandehuri apo gjyqtari i vetëm gjykues mund ta referoj çështjen, për këto vepra në ndërmjetësim. Para se ta bëjë këtë, prokurori i shtetit apo gjyqtari i vetëm gjykues merr parasysh llojin dhe natyrën e veprës, rrethanat në të cilat ajo është kryer, personalitetin e kryerësit dhe dënimet e mëparshme të tij për të njëjtën vepër penale apo për vepra penale të ndryshme, si dhe nivelin e përgjegjësisë penale të tij dhe nëse ndërmjetësimi është në interes të të dëmtuarit ose viktimës.”*, gjykata vlerëson se vepra penale për të cilën wshtw akuzuar M.K “Vjedhja e Shërbimeve” nga neni 314, paragrafi.6,lidhur me par.1 te KPRK-së, parashihet dënimi me gjobe ose me burgim deri ne tre (3) vjet, andaj i plotëson kushtet për të zbatuar dispozitat ligjore të procedurës alternative të ndërmjetësimit.

Me datë: 16.02.2024 në Zyrën për Ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Prishtinë është arritur marrëveshja Nd.67/2024, në mes të palëve në procedurë. Andaj, gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenit 15,te ligjit Nr.të Ligjit për ndërmjetësim e aprovoi këtë marrëveshje pasi që të njëjtën e vlerësoi se është lidhur me vullnetin e plotë të palëve në konflikt dhe në pajtim me ligjin në fuqi. Konform nenit 15 të Ligjit për ndërmjetësimin, nga data e pranimit nga gjykata, përkatësisht nga data 20.02.2024, e njëjta do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 453 par.1 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë konform nenit 357 par.1 nënpar. 1.3 të KPPK-së lidhur me nenin 2 dhe nenin 15 par. 1 të Ligjit për Ndërmjetësim, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM ,  
DIVIZIONI PENAL

P.nr.152/22 e datës: 20.02.2024

Bashkëpunëtori profesional,  
Asdren Selmani

Gjyqtari,  
Sabit Sadikaj

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa dhe e njëjta do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.